

eppc kërkon *Menaxher Projekti në Fushën e Turizmit* për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha në vend.

#### **NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM:**

Menaxheri i Projektit është përgjegjës për mbikëqyrjen, koordinimin, implementimin dhe përfundimin e projekteve.

#### **Përgjegjësitë Kryesore:**

1. Bashkërendon marrëdhëniet dhe komunikimin me autoritetet vendore për projekte të ndryshme për lejet, licensat dhe aplikimet e nevojshme gjatë fazave të zhvillimit të projektit;
2. Përgjegjës për bashkërendimin me studiot projektuese gjatë gjithë marrëdhënies me to për finalizimin e detyrave dhe harmonizimin e reflektimin e ndryshimeve;
3. Asiston në implementimin e projektit duke ofruar suport analitik, praktik dhe ndjekje periodike në terren;
4. Përpilon në bashkëpunim me Departamentin e Financës buxhetin e projektit, nevojës për financim/investim dhe nivelin e shpenzimeve të pritshme;
5. Merr pjesë në ndërtimin e planeve strategjike afatgjata dhe në implementimin e atyre operacionale;
6. Raportime periodike në lidhje me ecurinë e projektit pranë Departamentit të Projekteve.

#### **Kërkesat për këtë pozicion janë:**

- Diplomë Universitare në Shkencat Ekonomike/Juridike;
- Përvojë e mëparshme jo më pak se 5 vjetare në Drejtim/Menaxhim Projektsh;
- Njohuri shumë të mira të MS Office;
- Të jetë i aftë në proceset e planifikimit dhe organizimit të punës;
- Aftësi të mira komunikuese, bashkëpunuese dhe negociuese;
- Të ketë leje drejtimi dhe fleksibilitet për të udhëtuar.

#### **Të dhënat:**

<b>Pozicioni:</b>	Menaxher Projekti;
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë;
<b>Orari:</b>	Nga e Hëna në të Shtunë;
<b>Raporton tek:</b>	Drejtori i Departamentit;
<b>Pagesa:</b>	Në nivel drejtuesi;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	14.02.2016.

#### **Si të aplikoni:**

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mailit:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.